Kronikë

Fier, vijon 'Sundimi i ligjit', zbulohen dy lokale bastesh, procedohen 5 persona! Një i mitur kapet me armë zjarri teksa drejtonte makinën pa patentë

Në Fier policia ka zbuluar dy lokale ku kryheshin baste sportive. U proceduan 5 shtetas, teksa njëri është shpallur në kërkim. Ndërsa një 17-vjeçar u ndalua, pasi u kap me armë zjarri pistoletë, teksa drejtonte automjetin pa leje drejtimi.

Foto ilustruese

Redaksia
22 Mars, 11:45 | **Përditësimi: 22 Mars, 11:50**

Share

FIER - Vijon megaoperacioni 'Sundimi i ligjit' në mbarë vendin. Në lagjet 'Apollonia' dhe 'Liri' në Fier janë konstatuar dy lokale ku organizoheshin lojëra fati në kundërshtim me ligjin.

Është proceduar në gjendje të lirë pronari i lokalit në lagjen 'Liri', shtetasi F.K., 64 vjeç, ndërsa është shpallur në kërkim pronari i lokalit në lagjen 'Apollonia', shtetasi S.M.,33 vjeç.

Sakaq, janë proceduar në gjendje të lirë 3 shtetas të tjerë: Xh.K., 29 vjeç, F.A., 19 vjeç dhe M.Ç., 25 vjeç. Këta të tre u kapën teksa vinin baste sportive në këto lokale. Policia ka sekuestruar në këto dy lokale 3 makineta dhe 3 celularë.

LEXO EDHE:
Dita e Sulltan Nevruzit, si u festua në Fier! Besimtarët mblidhen te Teqeja e 'Baba Selimit'

'Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Fier, nga kontrollet e vazhdueshme në ambiente të ndryshme, të kryera me qëllim goditjen e rasteve të organizimit të kundërligjshëm të lojërave të fatit, kanë konstatuar se në 2 lokale, në lagjen "Apollonia" dhe lagjen "Liri", Fier viheshin baste sportive.

Në përfundim të veprimeve procedurale për këto raste, u procedua në gjendje të lirë pronari i lokalit në lagjen "Liri", shtetasi F. K., 64 vjeç, u shpall në kërkim pronari i lokalit tjetër, shtetasi S. M., 33 vjeç. Gjithashtu, u proceduan në gjendje të lirë, pasi u kapën teksa vinin baste sportive në këto lokale, shtetasit Xh. K., 29 vjeç, F. A., 19 vjeç, M. Ç., 25 vjeç.

Punohet për kapjen e 33-vjeçarit.', thuhet në njoftimin e policisë.

Po në Fier u kap në flagrancë një 17-vjeçar, pasi po lëvizte në qytet me armë zjarri të cilën e mbante në automjetin që drejtonte pa leje drejtimi. Në cilësinë e provës materiale iu sekuestrua arma e zjarrit me 13 fishekë brenda. Veprimet proceduriale me të miturin po kryhen në prani të psikologut, mbrojtësit ligjor dhe prindit.

G.K/Shqiptarja.com

TAG: Fier | sundimi i ligjit | baste sportive | Arrestime

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Debati për Zgjedhoren, a u intereson partive ndryshimi i ligjit elektoral?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Tiranë, kapen dy persona të shpallur në kërkim për shitje narkotikësh dhe mashtrim
22 Mars, 12:46

Itali, arrestohet 26-vjeçari shqiptar, vodhi sende argjendi dhe 250 kg produkte qumështi
22 Mars, 10:27

'Autostrada' energjetike Shqipëri-Maqedonia e Veriut! Banorët e Fierit që preken nga projekti në protestë: S'na japin dëmshpërblim për ullinjtë
Kristaq Thano
21 Mars, 16:28

Kampionati kombëtar, Apolonia e kickboxing 'gati për luftë': Duam të rikonfirmohemi kampionë të Shqipërisë
21 Mars, 14:27

Durrës, arrestohet 30-vjeçari, iu gjetën 116 mijë € në makinë, dyshohet të ardhura nga krimi (EMRI+VIDEO)
21 Mars, 12:05

Ish zv/ministri i Jashtëm i Greqisë viziton Fredi Belerin në burgun e Fierit: Kështu Shqipëria s'ka shanse t'i bashkohet BE
19 Mars, 13:48

Fier, dhunoi kushëririn, arrestohet në flagrancë 59-vjeçari
19 Mars, 09:46

Pamje pranverore nga qyteti antik i Apolonisë (Video)
18 Mars, 20:54

Aksident në aksin Fier-Sheq i Vogël, makina përplas biçiklistin e largohet nga vendi i ngjarjes
18 Mars, 19:17

Shpërthimi në magazinën e Bujar Çelës, GJKKO liron nga qelia sipërmarrësin Gjini: Arrestimi i paligjshëm! Lihet në fuqi pezullimi i 5 punonjësve
Keti Banushi
18 Mars, 12:45

Ish prefektja e Fierit shkon në SPAK! Në hetim se manipuloi 2 tendera, favorizoi firmën fituese në 32 prokurime! Ballia: Çfarë problemi ka?!
18 Mars, 11:35

Rritet numri i 15-vjeçarëve që përdorin drogë! Toksikologu në Fier: Adoleshentët në spital me axhitime, ja simptomat që kanë
Kristaq Thano
17 Mars, 15:45

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje